



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 27 Maj 2021

Nr: 369

V E N D I M

P Ë R

DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT NË KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALDEMOKRATE, QARKU SHKODËR, ZJ. JETMIRA REXHEP RRABOSHTA

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, dhe 164, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

V Ë R E J

Me shkresën nr. 1084 prot., datë 04.05.2021, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar si pasojë e dorëheqjes nga mandati i deputetit, të z. Tom Gjek Doshi, i zgjedhur në zonën zgjedhore, Qarku Shkodër, propozuar nga Partia Socialdemokrate.

Partia Socialdemokrate, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.68 , datë 20.03.2017.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 555, datë 26.07.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara në datë 25.06.2017 dhe miratoi listën shumemërore të deputetëve të zgjedhur për secilin subjekt në çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Socialdemokrate për zonën zgjedhore, Qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Qershor 2017, ka fituar 1 (një) mandat dhe kandidati fitues nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate, Qarku Shkodër, është numri rendor 01 (një) z. Tom Gjek Doshi.



Data: 27 Maj 2021
Nr. 369

Dhënie e mandatit të deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialdemokrate, Qarku Shkodër, zj. Jetmira Rexhep Rraboshta.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate, Qarku Shkodër, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor me kandidatin e radhës.

Sipas listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore, Qarku Shkodër, të Partisë Socialdemokrate, miratuar me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 290, datë 07.05.2017, rezulton se, kandidati të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 03 (tre) zj. Jetmira Rexhep Rraboshta.

Me shkresën nr. 5485 prot., datë 26.05.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për deputet, të listës shumemërore të Partisë Socialdemokrate, në zonën zgjedhore, Qarku Shkodër, zj. Jetmira Rexhep Rraboshta, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Për sa më sipër, kandidati për deputet, zj. Jetmira Rexhep Rraboshta, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 2347 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, të kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, Qarku Shkodër, për Kuvendin e Shqipërisë, zj. Jetmira Rexhep Rraboshta, rezulton se, nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, me shkresën nr. 5493 prot., datë 26.05.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 5492 prot., datë 26.05.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për Deputet, në zonën zgjedhore, Qarku Shkodër, për Kuvendin e Shqipërisë, zj. Jetmira Rexhep Rraboshta dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për Deputet, në zonën zgjedhore, Qarku Shkodër, për Kuvendin e Shqipërisë, zj. Jetmira Rexhep Rraboshta.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 5492/1 prot., datë 26.05.2021, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për Deputet, në zonën zgjedhore, Qarku Shkodër, për Kuvendin e Shqipërisë, zj. Jetmira Rexhep Rraboshta, e cila rezulton se nuk ka shënime në sistem.



Referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit konstatohet se, të dhënat e kandidatit për Deputet, në zonën zgjedhore, Qarku Shkodër, për Kuvendin e Shqipërisë, zj. Jetmira Rexhep Rraboshta, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e Deputetit në Kuvendin e Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit z. Tom Gjek Doshi, i përket kandidatit vijues në listën shumëmemërore të Partisë Socialdemokrate, në zonën zgjedhore, Qarku Shkodër, i renditur me numër rendor 03 (tre) zj. Jetmira Rexhep Rraboshta.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, dhe 164, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në Kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Socialdemokrate, në zonën zgjedhore, Qarku Shkodër, zj. Jetmira Rexhep Rraboshta.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

